

**OBLIGIMET E KOMUNAVE NGA AGJENDA EVROPIANE
MATRICA E GJITHPËRFSHIRËSE Janar-Qershor 2018**

Data e dorëzimit të raportit:	
Emri i komunës	
Emri i Kryetarit të Komunës	
Emri i Zyrtarit Komunal për IE :	
Detajet kontaktuese:	E-mail: Tel:
Informata të përgjishme mbi zhvillimin e proceseve të Integritimeve Evropiane në komunën tuaj?	<p>1.A është themeluar zyra komunale për Integritime Evropiane në komunën tuaj, nëse po si funksionon ?</p> <p>2.Sa zyrtarë janë në këtë zyrë dhe në kuadër të cilës drejtori funksionon zyra ?</p> <p>3.A ka zyrtari/zyra komunal për integritime Evropiane plan vjetor të punës ?</p> <p>4. A ka ndonjë mekanizëm tjetër komuna juaj (p.sh grup punues) nga drejtoritë përkatëse të cilat janë të obliguara të raportojnë në obligimet e Agjendes Evropiane në të cilat diskutohen arritjet dhe sfidat e përmbushjes së obligimeve nga Agjenda Evropiane në komunën tuaj, nëse po sa takime janë mbajturë gjatë kësaj periudhe ?</p> <p>5.Obligimet e komunës suaj të cilat dalin nga Agjenda Evropiane, a janë të inkorporuara në planin vjetor të Drejtorive përkatëse si dhe a është ndarë buxhet për realizimin e këtyre obligimeve?</p> <p>6.A merr pjesë Zyrtari për Integritime Evropiane në takimet që mbahen për planifikim të buxhetit vjetor / në mënyre që të ketë një monitorim më efikas mbi përfshirjen e obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane në planet e punës së drejtorive Komunale dhe planifikimin buxhetor të atyre planeve .</p>
	<p>1. Komuna e Prishtinës ka themeluar Sektorin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe integritimeve evropiane. Në kuadër të këtij sektori do të zhvillohen bashkëpunimet ndërkomunale, komunale, ndërkombëtare, si dhe do të mbulojë sferën e integritimeve evropiane. Udhëheqësi i sektorit është emruar më 15.06.2018;</p> <p>2. Në Komunën e Prishtinës është emruar udhëheqësi i Sektorit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integritime evropiane.</p> <p>3. Në Komunën e Prishtinës, është një (1) zyrtarë për integritime evropiane.</p> <p>4. Zyrtarja për integritim evropian mban kontakte të rregullta me drejtorët e drejtorive, si dhe shefat e sektorëve përkatës, sa i përket përmbushjes së veprimeve që dalin nga PKZMSA – ja. Takimet mbahen sipas nevojës. Zyrtarja merr pjesë në takimet e drejtorëve;</p> <p>5. Shumica e obligimeve janë pjesë e Planit të Komunës, por nuk është ndarë buxhet, andaj meqë obligimet e caktuara i përkasin drejtorive të caktuara, për ato veprime është caktuar buxheti;</p> <p>6. Zyrtarja për Integritime nuk merr pjesë në mbledhjet për</p>

				planifikim buxhetor;	
	Objektivi Strategjik duke u trajtuar	Drejtoritë përgjegjëse komunale	Pyetjet lidhur me zbatimin e aktiviteteve gjatë periudhës së raportimit	Përmbledhja e aktiviteteve të kryera gjatë periudhës së raportimit Janar – Qershor 2018	Ndërlidhja me dokumentet tjera strategjike dhe legjislacion
1. BLOKU I: KRITERET POLITIKE					
	1. Administrata publike				Neni 120 i MSA-së Administrata publike
	1.1. Forcimi i kapaciteteve të administratës në nivelin lokal, përfshirë komunat e sapo formuara, duke ofruar udhëzime nga niveli qendror tek ai lokal	Të gjitha Drejtoritë/ Njësitë/ Zyrat dhe Sektorët	<p>1. A është hartuar programi i trajnimeve për vitin 2018 në komunën tuaj?</p> <p>2. Sa është numri i zyrtarëve që janë përfshirë në planin e trajnimeve?</p> <p>3. Sa është buxheti i planifikuar në realizimin e planit të trajnimeve ?</p> <p>4. Sa është numri i trajnimeve të mbajtura sipas fushave përkatëse në</p>	<p>1. Komuna nuk e ka hartuar programin e trajnimeve për vitin 2018;</p> <p>2. Nuk ka plan;</p> <p>3. Nuk ka plan;</p> <p>4. Trajnime ka pasur gjatë periudhës raportuese për stafin e Komunës, të organizuara nga IKAP ose nga Institucione tjera; Zyrtarja për integritime evropian gjatë periudhës raportuese i ka ndjekur këto trajnime: “Përafrimi i legjislacionit vendor me legjislacionin e BE-së”, më 26 dhe 27 prill – IKAP; “Monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e politikave për integrimin e Kosovës në BE”, më 16 dhe 17 maj – IKAP; Trajnim për “Ligjin e përgjithshëm të</p>	

komunën tuaj ?

5.A keni databazë për meaxhimin e programit të trajnimeve ?

6. Sa është numri i zyrtarëve të komunës që kanë marrë pjesë në trajnime?

Procedurës Administrative”, më 11 dhe 12 qershor – MAP dhe Zyra E BE –së në Kosovë;

5. N/A

6. N/A

Drejtoria e Arsimit:

1. Në Drejtorinë e Arsimit është hartuar programi i trajnimeve për vitin 2018/2019.

2. Në Drejtorinë e Arsimit gjithsej janë përfshirë 8 zyrtarë.

3. Buxheti i planifikuar për realizimin e trajnimeve në DKA Prishtinë për vitin 2018 është 9.000 Euro, si dhe për këshilldhënie 1.000 Euro.

4. Në fushën e Arsimit janë organizuar 4 faza nga 150 mësimdhënës të trajnuar në një fazë.

5. Drejtoria e Arsimit mban të dhëna rreth organizimit dhe mbarvajtjes së trajnimeve të fushave përkatëse.

7. Zyrtarët e DKA-së kanë realizuar trajnime të ndryshme sipas sektorit dhe vendit të punës.

				<p>Qendra e Karrierës:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Trajnim per “Comptencies Passport”, maj – qershor 2018, 10 ditë – GIZ - Trajnim: “Management, Planning & Monitoring and Leadership &Team working Skills” (2.5 ditë) <p>“The Training Process for Career Guidance Programs and Presentation Skills” (2 ditë) “Career and Labor Market Information” (1 ditë) “Marketing, Public Relations and Digital Skills” (1.5 ditë) - Projekti EYE Helvetas</p>	
	1.2.Të zbatohet legjislacioni dhe politikat për reformën e administratës publike	Zyra e personelit	1.A është përgatitur Katalogu i vendeve të punës në Shërbimin Civil në komunën tuaj? (2 komuna)	1. Po është përgatitur katalogu i vendeve të punës;	

1.3. Të ngritet
transparenca e punës dhe
vendimmarrjes të nivelit
lokal

**Drejtoria e
Administratës
/Sektori i
Kuvendit/
Zyra për
Informim/**

1. Sa është numri i kërkesave
për qasje në dokumente
publike?

2. Sa është numri i
kërkesave të refuzuara dhe
aprovuara?

3. Sa është numri i akteve të
aprovuara nga Kuvendi i
komunës?

4. Sa akte të aprovuara nga
kuvendi i komunës janë
publikuar në ueb-faqen
zyrtare?

5. A janë publikuar në ueb
faqen e komunës tuaj të
gjitha aktet dhe dokumentet
e nxjerra nga organet e
komunave në gjuhët zyrtare
(nëse jo, ju lutem jepni
arsyet e mos publikimit në
gjuhët zyrtare)

6. A janë duke u
transmetuar mbledhjet e
kuvendeve përmes ueb faqes
komunale?

7. A keni problem me
transmetimin e
mbledhjeve në ueb faqet

1. Numri i kërkesave të pranuar për qasje në dokumente publike është 99;
2. Numri i kërkesave të aprovuara është 99 dhe nuk ka asnjë refuzim për qasje në dokumente publike;

3. Gjithsej 29 akte janë të miratuara nga Kuvendi i Komunës;

4. Të gjitha (29) aktet janë të publikuara në ueb-faqe, të cilat janë miratuar nga Kuvendi i Komunës:
<http://prishtinaonline.com/dokumente/vendimet/vendimet-2018>

5. Të gjitha aktet publikohen në të dy gjuhët:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/prishtine/category/vendimet/>

Serbisht: <https://kk.rks-gov.net/prishtine/sr/category/odluke/>

6. Të gjitha mbledhjet e Kuvendit transmetohen direkt për qytetarë:
<http://prishtinaonline.com/kerkimi/1673/ndiqeni-direkt-mbledhjen-e-katert-te-kuvendit-te-komunes-se-prishtines>

Arkivi i mbledhjeve:

<http://prishtinaonline.com/kuvendi/video-incizimet-e-mbledhjeve-te-kuvendit-te-komunes-se-prishtines>

<https://kk.rks-gov.net/prishtine/video-incizimet-e-mbledhjeve/>

7. Jo, për shkak se lidhja e drejtpërdrejtë krijohet në Youtube, kurse vetëm linku del në ueb-faqe;

			<p>komunale, nëse po specifikone problemet ?</p> <p>8.A ka forma të tjera të transmetimit të mbledhjeve të kuvendeve ?</p> <p>9. Sa takime publike gjithëpërfshirëse me qytetarë janë mbajtur gjatë periudhës raportuese (konform nenit 68.1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale)?¹</p> <p>10. Sa takime të tjera informuese janë mbajtur me qytetarë në lokacione, lagje, fshatra dhe vendbanime, lidhur me çështje të ndryshme të interesit publik (specifikoni temat e diskutimeve) ?</p> <p>11. A mbahen procesverbale gjatë këtyre takimeve dhe a publikohen në ueb faqe të komunave këto procesverbale ?</p>	<p>8. Jo, nuk ka, përveç transmetimit direkt nëpërmjet kanalit Youtube;</p> <p>9. Gjatë periudhës raportuese, janar – qershor 2018, është mbajtur një diskutim i përgjithshëm publik, konform nenit 68.1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale;</p> <p>10. Gjatë këtij gjashtëmujori janë mbajtur 12 diskutime publike: http://prishtinaonline.com/uploads/debatet-publike-2018%20(1).pdf</p> <p>11. Të gjitha procesverbalet gjenden te Shërbimi i Kuvendit;</p> <p>12. Komuna e Prishtinës, nëpërmjet Platformës digjitale për participim publik, të gjitha kërkesat e paraqitura nga qytetarët i shqyrton, dhe në bazë të prioriteteve fillon realizimin e tyre. Kërkesa fizike të qytetarëve të drejtuara në QSHQ. Kërkesat e paraqitura nga kryetarët e Bashkësive Lokale.</p> <p>13. Janë mbajtur 5 diskutime publike për rregullore: http://prishtinaonline.com/uploads/debatet-publike-2018%20(1).pdf</p>	
--	--	--	--	--	--

¹ Neni 68.1 I Ligjit për vetëqeverisje lokale obligon së paku 2 takime publike në vit në të cilat mund të marr pjesë secili person apo organizatë me interes në komunë.

			<p>12. Cilat janë format ose ndonjë praktike tjetër që komuna ka marrë në konsiderat opinionet e qytetarëve gjatë vendimarrjes ?</p> <p>13. Sa takime konsultative me qytetarë janë mbajtur lidhur me propozim-aktet e kuvendit të komunës (rregullore, statute, plane etj)?</p>		
	<p>1.4.Të vazhdohet procesi i decentralizimit për komunat: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zvecan, Leposaviq</p>	<p>Drejtoria e Administratës</p>	<p>1.A ka filluar procesi i funksionalizimit të Administratës komunale?</p> <p>2. Cfarë veprime janë ndërmarrë për themelimin e drejtorive në kuadër të administratës komunale?</p> <p>3. A janë themeluar Qendrat për shërbim të qytetarëve?</p> <p>4. A është duke funksionuar sistemi i intranetit në kuadër të shërbimeve</p>	<p>3. Qendra për shërbim me qytetarë, e themeluar dhe funksionale;</p> <p>4. Po ashtu, sistemi i intranetit ne kuadër të shërbimeve funksionale;</p>	

			administrative që ofron komuna?		
	1.5.Të zbatohet në mënyrë sistematike rekrutimi i stafit civil i cili është bazuar me ligj	Drejtoria e Administratës /Zyra e personelit	<p>1. A është themeluar komiteti për komunitete në komunën tuaj?</p> <p>2. Sa mbledhje të këtij komiteti janë mbajtur në periudhën raportuese?</p> <p>3. A është emëruar zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete? (së paku 10% e qyetarëve nga komunitetet joshumicë)</p> <p>4. A është emëruar nënkryetari i komunës për komunitete (së paku 10% e komuniteteve joshumicë)?</p> <p>5. Të shtohet pjesa e përfaqësimit të komuniteteve joshumicë në organet e komunës (kapitulli administrata publike, dhe vetëqeverisja lokale?</p>	<p>1. Po, është themeluar Komiteti për komunitete: http://prishtinaonline.com/uploads/komiteti_per_komun..pdf</p> <p>2. Janë mbajtur 4 mbledhje, Komiteti për komunitete: http://prishtinaonline.com/kuvendi/procesverbalet/procesverbalet-2018/thirrjet-per-komitetin-per-komunitete;</p> <p>3. Jo, nuk është emëruar;</p> <p>4. Jo, nuk është emëruar nënkryetari për komunitetin jo shumicë;</p> <p>8. Janë gjithsej 9 (nëntë) zyrtarë që i parkasin komunitetit joshumicë, të angazhuar në institucionet publike;</p>	

			<p>6. Çfarë përpjekje dhe veprime ka ndërmarrë Komuna që Komunitetet jo-shumicë të përfaqësohen në mënyrë adekuate në institucionet publike në komunën tuaj?</p> <p>7. Sa është numri i të punësuarave të komuniteteve jo shumicë në institucionet publike?</p>		
	2. Avokati i Popullit				
2.1. Të përmirësohen kushtet për funksionimin e Institucionit të Avokatit të Popullit	Drejtoria e Administratës	1. A janë të qasshme për personat me aftësi të veçanta, hapësirat e punës së institucionit të Avokatit të Popullit në institucionet lokale (Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Ferizaj, Gjilan, Graçanicë, Mitrovicë, Mitrovicë Veriore)? (3 komuna)	1. Institucioni i Avokatit të Popullit në Prishtinë i ka hapësirat e qasshme për të gjitha kategoritë;		
2.2. Të zbatohen rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit	Njësia për të	1. Sa është numri i kërkesave/rekomandimeve të cilat Komuna i ka pranuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit (nëse po listoni	Nuk është në kompetenca të NJDNJ –tek NJDNJ nuk drejtohen, ato dorëzohen në Zyrën pritëse dhe u shpërndahen drejtorive apo kabinetit ku janë të dedikuara		

		Drejtat e Njeriut dhe Komunitete	<p>ato), si dhe cilat janë masat që komunat kanë ndërrmarë lidhur me rekomandimet e pranuar?</p> <p>2. Sa përgjigje pozitive i ka kthyer Komuna Institucionit të Avokatit të Popullit?</p> <p>3. Sa përgjigje negative i ka kthyer Komuna Institucionit të Avokatit të Popullit?</p> <p>4.Sa kërkesa/rekomandime janë në proces të shqyrtimit?</p>		
	3.Shoqëria civile				
	3.1.Të rritet bashkëpunimi në mes të organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të Qeverisë së Kosovës, si dhe të sigurohet financim publik për shoqërinë civile	Drejtoria për Financa dhe Buxhet	<p>1. Sa është buxheti i planifikuar për projektet e OSHC-ve ?</p> <p>2. A janë zbatuar procedurat sipas Rregullores së re të MF—4/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit të OJQ-ve?</p> <p>3. Cilat kanë qenë objektivat e përcaktuara në kuadër të</p>	<p>1. Buxheti i planifikuar per OSHC është: 1,526,810.00 euro për vitin 2018.</p> <p>2. Procedurat sipas rregullores së re M F-04/2017, mbi kriteret, standartet dhe procedurqat e financimit të OJQ-ve janë zbatuar. Aplikimi ka qenë online në Drejtorinë e Kulturës, duke e bërë edhe më transparent procesin.</p> <p>3. Objektivat e përgjithëshme të kësaj thirrjeje është që Komuna e Prishtinës ofron përkrahje për biznese dhe OJQ, si edhe Individë me aftësi te posaçme kreative, në fushtat e kulturës dhe ofrojnë</p>	

		<p>shpalljes për projekt propozimet?</p> <p>4.Sa është numri i OSHC-ve të përkrahura financiarisht nga komuna?</p> <p>5.Sa është numri i projekteve që ka financuar komuna?</p> <p>6. Në kuadër të cilave grupe punuese (komisioneve) të kuvendit janë përfshirë OJQ-të ?</p> <p>7. Shëno emrat e OJQ-ve të përfshira në kuader të këtyre grupeve punuese?</p> <p>8.Sa është shuma e përgjithshme e ndarë për përkrahjen e aktiviteve të OSHC-ve?</p>	<p>mbështetjen e tyre me transparencë të plotë dhe pa kurrfarë diskriminimi.</p> <p>4. Në Sektorin e Kulturës janë përkrahur 29 OJQ, ndërsa në Sektorin e Sporti dhe Rinisë janë përkrahur gjithsej 20 OJQ, si dhe janë në procesin e nënshkrimit të kontratave.</p> <p>5. Në Sektorin e Kulturës janë përkrahur 58 projekte, ndërsa në Sektorin e Sportit dhe Rinisë janë përkrahur 84 projekte për fazën e parë të aplikimit online.</p> <p>6. Nga Shoqëria civile janë të përfshira në Keshilin Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB.</p> <p>7.OJQ "Organizata ART", perfaqes Alush Gashi.</p> <p>8. Shuma e planifikuar e buxhetit për vitin 2018 për OJQ është: 1,526,810.00 euro</p>	
<p>4.Lufta kundër terrorizmit</p>				<p>Neni 92 Lufta</p>

4.1.Të përforcohen strukturat e Kosovës në parandalimin dhe eliminimin e akteve terroriste dhe financimit të tyre

Kordinatori i Sekretariatit/ Kuvendi i Komunës

1. Cilat janë veprimet/aktivitetet që ka ndërmarrë komuna e juaj për vetëdijësimin e qytetarëve kundër radikalizmit që mund të shpiej në ekstremizëm të dhunshëm ?

2. A ka pasur ndonjë rast të raportuar në KKSB për aktivitetet që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin ?

3. A është kërkuar nga Drejtori i Policisë për të raportuar lidhur me gjendjen e sigurisë në Kuvendin e Komunës dhe a është raportuar ?

**kundër
terrorizmit
- MSA**

4.2.Të krijohen mekanizma për raportim obligativ lidhur me konfliktin e interesit si dhe të ashpërsohen sanksionet lidhur me mos deklarimin e pasurisë dhe konfliktin e interesit

Kordinatori i Sekretariatit/ Kuvendi i Komunës

1.Sa është numri i personave zyrtar të obliguar për deklarimin e pasurisë tek AKK?

2. Sa është numri i zyrtarëve që kanë deklaruar pasurinë?

3.Sa është numri i deklarimeve të konflikteve të interesit nga zyrtarët komunal ?

4. Sa është numri i anëtarëve të kuvendit që kanë deklaruar konfliktin e interesit para marrjes së vendimeve në kuvend të komunës?

1. Numri i personave zyrtarë që janë të obliguar të bëjnë deklarimin e pasurisë për vitin 2018, janë gjithësejt 76 zyrtarë;
2. Të gjithë këta zyrtarë kanë bërë deklarimin e pasurisë;
3. Gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur asnjë rast të deklarimit të konfliktit të interesit;

<p>4.3.Monitorimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsion;</p>	<p>Kordinatori i Sekretariatit/ Kuvendi i Komunës</p>	<p>1. A ka hartuar komuna juaj Planin Lokal për Integritet? 2. A ka komuna juaj zyrtar që raporton për Planin Lokal për Integritet ? 3. Sa është numri i raporteve të publikuara mbi monitorimin e zbatimit të Planit Lokal për Integritet.</p>	<p>1. Më 25 maj 2018, është formuar Komisioni për hartimin e Planit lokal për integritet; 2. Pas hartimit të planit do të caktohet edhe zyrtari për raportimin mbi zbatimin e Planit; 3. N/A</p>	
<p>5. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve</p>				
<p>5.1.Zbatimi i pakove ligjore për të drejtat e njeriut</p>	<p>Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete</p>	<p>1.Numri dhe lloji i aktiviteteve të komunës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në lidhje me zbatimin e legjislacionit për të drejtat e njeriut? 2.A është hartuar rregullorja komunale për parandalimin e punëve të rënda për fëmijët në komunën tuaj? 3. A është miratuar rregullorja komunale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve?</p>	<p>1. Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur 3 aktivitete sa i përket komunitetit LGJBT, anti diskriminim dhe fushata kundër trafikimit 2. Rregullorja komunale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve është hartuar, pritet që të kalojë në Kuvend për miratim, ku e përfshin edhe këtë segment; 3. Po, është përfunduar hartimi, jemi në proces të procedurave të tjera deri te miratimi në Kuvendin e Komunës.</p>	

			<p>4.Sa është numri i trajnimeve për zyrtarët komunal për pakon ligjore për të drejtat e njeriut? (<i>Ligji nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit (LAP), Ligji nr. 05/L -020 për barazi gjinore (LBGJ) dhe Ligji nr. 05/L -021 për mbrojtjen nga diskriminimi</i>)</p>	<p>4. Gjatë 6 mujorit, këti viti nuk është mbajtur asnjë, por gjat vitit të kaluar kemi mbajtur dhe tash vetëm duhet të zbatohet.</p>	
	5.2.Të drejtat e grave dhe barazia gjinore	<p>Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete</p>	<p>1. Sa raste të dhunës mbi baza gjinore ka trajtuar komuna juaj?</p> <p>2.A ka themeluar komuna këshillin komunal për mbrojtën e viktimave te dhunës ne familje dhe baza gjinore, nëse po sa takime janë mbajtur?</p>	<p>1. 59 femra QPS</p> <p>2. Po, Këshilli komunal për mbrojtën e viktimave të dhunës në familje dhe baza gjinore, takohen çdo 3 muaj;</p>	

	5.3.Të drejtat e fëmijëve	Njësia për të Drejtat e Njeriut	1.Cilat janë veprimet që ka ndërmarrë komuna, duke përfshirë edhe planifikimin buxhetor, për të ngritur kapacitetin e koordinorit apo zyrtarit komunal për të drejtat e njeriut/fëmijëve?	1. NJDNJ nuk ka buxhet, gjithashtu koordinatori i NJDNJ është edhe zyrtar për të drejtat e fëmijëve.	
	5.4.Të fuqizohet roli dhe pozita e femrës në shoqëri	Njësia për të Drejtat e Njeriut	1. Sa është numri i femrave në pozita menaxheriale në të gjitha institucionet e komunës (p.sh. administratë, shkolla, QMF etj)? 2.Sa është numri i femrave në pozita menaxheriale në të gjitha institucionet e komunës (p.sh. administratë, shkolla, QMF etj)? nga komunitetet jo shumicë?	1. Katër (4) drejtore komunale, 1 drejtore QKMF. Drejtoria a Arsimit: 1. Në Shkollat e Prishtinës në Institucionet parashkollore janë tetë (8) pozita menaxheriale, në shkollat fillore njëzet e dy (22) femra në pozitën menaxheriale, ndërsa në shkollat e mesme tri (3) femra në pozitën menaxheriale, gjithsej në IEAA janë tridhjet e tri (33) femra në pozitën menaxheriale. Nga komuniteti jo shumicë në pozitën menaxheriale në shkolla kemi vetëm një (1)	

			<p>3.Sa është numri total i përfaqësimit të femrave në administratën publike lokale duke përfshirë Kuvendin e Komunës ?</p> <p>4. Sa është numri total i përfaqësimit të femrave nga komunitetet jo shumicë në administratën publike lokale duke përfshirë Kuvendin e Komunës?</p>	<p>femër.</p> <p>2. Janë gjithsej 264 femra.</p> <p>3. Janë 7 femra të komunitetit jo shumicë në administratën dhe Kuvendin e Komunës.</p>	
5.5.Zbatimi i të drejtave pronësore	Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete/Zyra për Barazi Gjinore	1. Cilat janë veprimet që ka ndërmarr komuna juja me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe përmirësimit për të drejtat pronësore të grave, dhe cila është natyra e tyre?	1. Komuna e zbaton UA (QAK) 08/2018 për ndryshime dhe plotësimin e UA (QAK) nr. 03/2016 ; Poster informues; Gjatë fushatave gjithmonë, një ndër temat është edhe “Ndërgjegjësimi për të drejtat pronësore të grave”.		
5.6.Lufta kundër trafikimit		1.Sa raste të strehimit dhe			

me qenie njerëzore	Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete /Drejtoria për Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	<p>të kompensimit të viktimave të trafikimit janë evidentuar në komunën tuaj?</p> <p>2. A ka siguruar Komuna ndihmë për viktimat e komuniteteve pakicë kundër trafikimit dhe kundër dhunës në familje?</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Nuk ka asnjë rast që iu ka siguruar strehimi rasteve të përmendura. 2. Komuna nuk ka siguruar ndonjë ndihmë të veçantë për viktimat e komuniteteve pakicë kundër dhunës në familje, mirpo në qoftë se paraqitet ndonjë rast, trajnimi i tyre do të bëhet përmes Qendrës per Pune Sociale, në pajtim me legjislacionin në fuqi, si për çdo qytetar tjetër të komunes sonë, pa ndonjë diskriminim. Nuk kemi të siguruar ndonjë ndihmë të vecantë për komunitetet pakicë. 	
5.7.Buxheti dhe sfidat në nivel qendror dhe lokal	Drejtoria për Financa dhe Buxhet	1. A ka ndarë komuna juaj buxhet për mbrojtjen e komuniteteve pakicë? Nëse po, sa është buxheti?	<p>1. Drejtoria : Zyra për komunitete dhe kthim</p> <p>Paga dhe mëditje – 30,000.00 euro</p> <p>Mallra dhe shërbime – 120,000.00 euro</p> <p>Komunali – 17,417.00 euro</p> <p>Buxheti për vitin 2018.</p>	
5.8.Të përmirësohet implementimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve	Zyra ligjore/Zyra informimit	<p>1. A ka komuna juaj rregullore për përdorimin e gjuhëve zyrtare?</p> <p>2.A është rekrutuar stafi i nevojshëm dhe profesional</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Po, Komuna e ka Rregullorën për përdorimin e gjuhëve zyrtare: http://prishtinaonline.com/uploads/110-286.pdf 	

			<p>për përkthim?</p> <p>3. Çfarë veprime ka ndërmarrë Komuna për të krijuar qasje për shërbime në gjuhët zyrtare në nivel komunal, duke përfshirë gjuhët që përdoren nga komunitetet pakicë në komunën tuaj?</p>	<p>2. Janë të angazhuar: një përkthyes shqip – serbisht, përkthyes i gjuhës angleze tash për tash nuk ka të angazhuar;</p> <p>3. Komuna e ka përkthyesin, e ka Rregulloren për përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe në ueb-faqen e Komunës publikohen dokumente në gjuhë zyrtare që përdoren në Komunë;</p>	
	<p>6.Mbrojtja dhe promovimi trashëgimisë kulturore</p>				

6.1. Avancimi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore

**Drejtoria e Kulturës/
Drejtoria përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë (Urbanizmi)**

1. Cilat janë veprimet/aktivitetet që komuna juaj ka ndërmarrë lidhur me definimin dhe trajtimin e perimetrave, zonave të mbrojtura, sipërfaqeve të mbrojtura dhe shenjzimin e aseteve të Trashëgimisë Kulturore? (te ndahet veq e veq)

2. A është bërë studimi i fizibilitetit dhe projektit ideor në komunën tuaj për sa i përket themelimit të Muzeut të Natyrës? **(Prishtina dhe Fushë Kosova)**

3. A është themeluar Muzeu i Natyrës në Komunën tuaj? **(Prishtina dhe Fushë Kosova)**

1. Në kuadër të nismës thelbësore për ruajtje të trashëgimisë kulturore, kemi bërë marrëveshje bashkëpunimi me Fondacionin Trashegimia Kulturore pa Kufi "CHWB", kjo marrëveshje ka dy objektiva kryesorë:

- Planifikimi dhe revitalizimi i "Rrugës Model" për Qendrën Historike të Prishtinës, që do të planifikohet dhe projektohet një rrugë në zonën e Qendrës Historike të Prishtinës.
- Ripërcaktimi i kufirit për Zonën Historike. Komuna e Prishtinës posedon kufirin e Zonës së Trashegimisë Kulturore, sipas PZHU-së dhe i përmbahet të gjitha rregullave të cilat janë të përcatuara për implementimin e këtij kufiri, mirëpo për t'u përshtatur me situatën në terren, duhen disa intervenime, të cilat do të bazohen nga përvoja me "Rrugën Model".

Përveç marrëveshjes me CHWB, kemi bërë marrëveshje me "Swisscontact", por edhe me Ministrinë e Kulturës dhe institucionet e saj vartëse që lidhen me trashëgimi kulturore, për shenjzime dhe për promovim të trashëgimisë. Disa pika janë ndërmarrë në këtë drejtim:

- Drejtoria e Kulturës ka nisur projektin e shenjzimit vertikal, në kuadër të masave turistike që po i ndërmarrim. Së shpejti do të vendosen 32 shenjzues në gjithë Prishtinën. Shumica prej tyre janë për ndërtesat e trashëgimisë kulturore.
- Ne kemi filluar 6 projekte për restaurim dhe konservim të ndërtesave të trashëgimisë kulturore. Puna në disa prej tyre tashmë ka filluar, si për shembull te ndërtesa e ish-Konsullatës në Qendër Historike. Kurse

projekti për Shkollën e Parë Shqipe dhe për Sali Safqe, është gati dhe priten të fillojnë punimet. Projekte në përpilim e sipër janë për Hamamin e Vjetër, për ish-Kadastrin (Objektin prapa objektit të vjetër të Komunës) dhe për ish-objektin e bibliotekës “Hivzi Sylejmani”.

- Në kuadër të projekteve të konservimit është duke u punuar intenzivisht për “Rrugën Model” në kuadër të Qendrës Historike të Prishtinës.
- Kemi aplikuar për t’u bërë pjesë e ATRIUM, që është një udhë turistike evropiane që mbron trashëgiminë moderniste të fillimit të shekullin 20.

2. “Muzeu i Natyrës” është projekt i iniciuar nga Ministria e Kulturës, e cila ka ndërmarrë disa hapa për themelimin e këtij muzeu në Prishtinë, apo në rajonin e Prishtinës. Megjithëse ne nuk kemi qenë palë zyrtarisht në këtë proces, ndaj dhe nuk i kemi informatat për studimin e fizibilitetit. E kemi ndjekur me shumë interesim rrjedhën e ngjarjeve. E dijmë se për këtë muze është ndarë një lokacion në Harilaq, kurse projekti ideor është përzgjedhur.

3. Muzeu i Natyres ka ekzistuar si institucion dhe ka qenë aktiv në objektin ku sot ndodhet Muzeu Etnologjik, por sot është pasiv dhe

				<p>jashtë funksionit. Pas vitit 1999 të gjitha artefaktet janë duke u ruajtur ne Muzeun Kombetar të Kosoves, kurse Ministria e Kultures është duke u marrë me rinisjen e tij si muze funksional. Komuna e Prishtinës, përkatësisht Drejtoria e Kultures ka interesim të jashtëzakonshëm për këtë projekt dhe është në dispozicion për çfarëdo bashkëpunimi në këtë drejtim me të gjitha institucionet relevante. Ne si Komunë disa herë kemi nisur iniciativën për muze të shkencës, por ende nuk e kemi një studim fizibiliteti për diçka të tillë.</p>	
--	--	--	--	--	--

6.2. Të implementohet legjislacioni që ka të bëjë me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore

**Drejtoria e Kulturës/
Drejtoria përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë (Urbanizmi)**

1. A ka komuna juaj Plan për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore?

2. Sa është numri i shkeljeve dhe ndërtimeve ilegale në zonat e mbrojtura?

3. Çfarë masa janë ndërmarrë ndaj shkeljeve të evidentuara të ndërtimeve pa leje në zonat e mbrojtura?

4. A janë siguruar pajisjet për monitorimin e sigurisë/instalimi i kamerave të tërësive të objekteve të trashëgimisë kulturore (objektet e kultit fetar, zonat e mbrojtura, muzetë, etj) ?

5. A janë nënshkruar Memorandume të bashkëpunimit për detyrat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e Kishave Ortodokse? **(Vetem komunat që kanë kisha)**

1. Komuna e Prishtinës e ka përpiluar një plan për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, si dokument intern që përcakton hapat dhe veprimet në vitet në vijim. Ky plan për momentin nuk është në ueb-faqen e Komunës, por Plani iu është shpërndarë palëve që janë në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës.

2. Regjistër nga shkeljet e kaluara nuk është mbajtur në Komunë. Por në gjendjen e tanishme shumica e ndërtesave të trashëgimisë kulturore, janë të neglizhuara nga pronarët, këtë e evidentojnë edhe raportet nga Inspeksioni i Komunës. Kjo na ka shtyrë neve si institucion të ndërhyjmë, duke u fokusuar në 6 ndërtesa në Qendrën Historike të Qytetit. Prishtina në regionin e saj ka në përbërje 7 komuna: Prishtinën, Podujevën, Obiliqin, Drenasin, Lipjanin, Fushë Kosovën dhe në listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme janë të listuara gjithsej 118 objekte, prej të cilave: 51 profane, 27 sakrale dhe 35 utilitare.

3. Ne kemi ndërmarrë masa të stabilizimit, mbrojtjes dhe renovimit të ndërtesave të rrezikuara të trashëgimisë kulturore, duke bërë projektet e konservimit, pastrimit dhe evidentimit të ndërtesave, stambilizimit përmes skeleve dhe tjera formave profesionale në gjashtë ndërtesa të trashëgimisë kulturore në Prishtinë.

4. Komuna nuk ka bërë ndonjë veprim lidhur me vendosjen e kamerave, apo pajisjeve për monitorimin e sigurisë së objekteve të trashëgimisë kulturore, mirëpo ne disa prej këtyre objekteve ka vendosur sigurim fizik.

5. Komuna e Prishtinës nuk ka ndonjë marrëveshje apo memorandum bashkëpunimi për mbrojtjen apo

	<p>6.3.Zbatimi i Ligjit për Hoçën e Madhe. Krijimi i Këshillit të fshatit dhe zgjedhja e anëtarëve për zbatimin e Ligjit për Hoçën e Madhe? Arsyet nëse nuk është bërë ende dhe cilat janë planet tuaja dhe të komunës</p>	<p>Sekretaria e Kuvendit Komunal/Zyra për Fshatin Hoqë e Madhe</p>	<p>1. A është funksional Këshilli i fshatit për Hoçën e Madhe?</p> <p>2. Cilat janë veprimet që komuna ka ndërmarrë?</p> <p>3. Cilat janë veprimet e komunës për zbatimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit?</p> <p>4. A janë siguruar fondet për stafin dhe pajisjes për Këshillin e Trashëgimisë Kulturore në Prizren në mënyrë që ai të funksionojë ashtu siç është paraparë me Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit?</p>	<p>Komuna e Prishtinës nuk ka ndonjë marrëveshje apo memorandum bashkëpunimi për mbrojtjen apo mirëmbajtjen e kishave ortodokse;</p>	
	<p>6.4. Ofrimi i informatave për atë se çfarë veprime përcjellëse dhe masa ndëshkuese janë ndërmarr ndaj atyre që shkelin ligjet (Ligji për ZVM, Ligji për Hoçën e Madhe dhe për Qendrën</p>	<p>Sekretaria e Kuvendit Komunal/Zyra për Fshatin Hoqë e Madhe</p>	<p>1.Çfarë masa ndëshkuese kanë ndërmarrë komunat ndaj atyre që shkelin ligjet (Ligji për ZVM dhe Ligji për Hoçën e Madhe Ligji dhe për Qendrën Historike të Prizrenit)?</p>		

	Historike të Prizrenit)				
	6.5.Ndërmarrja e veprimeve në adresimin e problemit të ndërtimeve ilegale brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura (ZVM)? Raportim mbi aktivitetet e ndërmarra nga Task Forca e ngritur për t'u marrë posaçërisht me ndërtimet e paligjshme në Prizren. Planet e ardhshme për këtë Task Force sipas qeverisë së re	Sekretaria e Kuvendit Komunal	<p>1.Sa është numri i ndërtimeve ilegale brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura në Komunën e Prizrenit?</p> <p>2.Çfarë aktivitete ka ndërmarrë Task Forca për sa i përket ndërtimeve të paligjshme, në Komunën e Prizrenit?</p> <p>3. A janë caktuar inspektorët komunal për të inspektuar ndërtimet pa leje në Zonën e Mbrojtur të qytetit?</p>		
	6.6. Raportoni lidhur me organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit dhe promovimin e përkushtimit më të fuqishëm për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore	Drejtoria e Kulturës	<p>1.Cilat janë aktivitetet që komunat kanë ndërmarrë për ndërgjegjësimin dhe promovimin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore? (Krejt komunat)</p> <p>2. Cilat janë format e</p>	<p>-Komuna e Prishtinës ka iniciuar rregullimin e shkollës së parë shqipe në Prishtinë.</p> <p>- Relevimi dhe restaurimi i ish-objektit të bibliotekës “Hivzi Sylejmani” dhe konvertimi në muzeun “Ibrahim Kodra”.</p> <p>- Projekti emergjent i shtëpisë së Sali Safqes.</p> <p>-“Rruga Model”, punët kryhen në bashkëpunim me</p>	

			<p>bashkëpunimit me Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore?</p>	<p>Fondacionin “Trashëgimia Kulturore Pa Kufij- CHwB” gjegjësisht evidentimi, mbrojtja dhe restaurimi.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ish-objekti i Kadastrit, restaurimi për momentin është në tenderim për projekt. - Ish-objekti i Konsullatës, puna është në proces të pastrimit dhe restaurimit të objektit. - Vendosja e shenjëzimeve me informata për objektet dhe lokacionet e trashëgimisë kulturore. - Qendra informuese që do të shërbejë për turistët në Prishtinë dhe do të përmbajë informata që do të mbledhen nga organizata joqeveritare që punojnë në fushën e trashëgimisë kulturore dhe biznese, kjo për të lehtësuar dhe kursyer kohën e turistëve. Poashtu, duke promovuar lokacione të ndryshme në Prishtinë, që nuk janë edhe aq shumë të njohura për turistët. <p>_____</p> <p>2. Bashkëpunimi me Komunën për pikën 1, QRTK dhe Komuna e Prishtinës kanë bashkëpunim të vazhdueshëm.</p>	
	<p>6.7. Ofrimi i informacionit mbi caktimin dhe/ose konfirmimin e alokimit të buxhetit për Këshillin e Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit dhe Këshillit të fshatit të Hoqës së Madhe për të mundësuar funksionimin e tyre të suksesshëm;</p>	<p>Sekretaria e Kuvendit Komunal / Zyra për Fshatin Hoqë e Madhe</p>	<p>1.A është alokuar buxheti për Këshillin e Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit për të mundësuar funksionimin e suksesshëm dhe sa është shuma?</p> <p>2. A është alokuar buxheti për Këshillin e fshatit të Hoqës së Madhe për të</p>		

			mundësuar funksionimin e suksesshëm dhe sa është shuma?		
2. BLOKU II: KRITERET EKONOMIIKE					
	1. Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut				
	1.1. Lehtësimi i procedurave të bërjes biznes në komuna	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	<p>1.A është themeluar Qendra për regjistrimin e bizneseve (one-stop shopet) në komunën tuaj?</p> <p>2.Sa është numri i trajnimeve të organizuara për stafin e Qendrave për regjistrimin e bizneseve (one-stop shopet) në komunën tuaj?</p> <p>3. Sa është numri i stafit të trajnuar në këtë fushë?</p>	<p>1.Qendra për regjistrimin e bizneseve nuk është themeluar ende;</p> <p>2.Nu ka trajnime, për shkak të mos funksionimit të Qendrës;</p>	
	1.2. Përmirësimi i mëtejshëm i ambientit në të bërit biznes	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizem	<p>1.Sa është numri i bizneseve të regjistruar në komunë tuaj sipas veprimtarive ?</p> <p>2.Sa është numri i bizneseve të regjistruara ?</p> <p>3.Sa është numri i bizneseve</p>	<p>1. Rexhistrimi i bizneseve bëhet në ARBK në MTI (Komuna e Prishtinës nuk e ka të deleguar kompetencën e regjistrimit të bizneseve nga MTI), andaj për të gjitha këto shënimet janë</p>	

të mbyllura?

4. Sa është numri i bizneseve aktive ?

5. Sa është numri i bizneseve të udhëhequr nga gratë?

6. Cilat janë vështërsitë e të bërit biznes në komunën tuaj dhe cilat janë format e mbështetjeve të bizneseve?

7. Cilat janë veprimet të cilat i ka ndërmarr komuna e juaj lidhur me zvogëlimin e mëtejshëm të barrierave të të bërit biznes?

8. Sa ka ndarë buxhet komuna juaj për subvencionimin e bizneseve?

9. A janë funksionale Qendrat për promovimin e bizneseve?

10. A ka komuna juaj inspektorë të tregut (specifiko numrin e tyre)?

në MTI;

2,3,4,5. Nuk ka të dhëna për arsyet e cekura më lart.

6. Bizneset nuk subvencionohen direkt, mirëpo nëpërmes programeve të ndryshme krijohen forma të lehtësimit, si dhe zvogëlimi i taksës komunale për biznes;

7. Harmonizimi i Rregullorës për taksën Komunale për biznes, pastaj harmonizimi i Rregullorës për orarin e punës për biznese etj;

8. Bizneset nuk subvencionohen direkt, mirëpo nëpërmes programeve dhe projekteve të ndryshme krijohen format të lehtësimit të afarizmit të tyre;

9. Egziston Qendra për Zhvillim në Karrierë, e cila njëkohësisht bën edhe promovimin e biznesit për Komunën e Prishtinës;

10. Sqarim: Inspektorët e tregut janë në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit.

<p>1.3.Procedurat e planifikimit të buxhetit nuk kanë qenë transparente dhe të koordinuar deri më tani. Programet e shpenzimeve të buxhetit nuk janë përputhur me prioritetet afat gjata të qeverisë.</p>	<p>Drejtoria për Financa dhe Buxhet</p>	<p>1.Sa dëgjime publike janë mbajtur për planifikimin e buxhetit? (të raportohet në K4)</p> <p>2. Cilat janë format e përfshirjes së qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve tjera të interesit në planifikimin e buxhetit?</p>	<p>1. Deri më tani nuk kem pasur dëgjime publike. Të gjitha dëgjimet publike janë paraparë ne muajin korrik 2018 dhe gjithsej janë 5 dëgjime publike.</p> <p>2. Takime me qytetarë, dëgjimin e ankesave të tyre, mundësitë e realizimit të kërkesave dhe ankesave të qytetarëve të komunës së Prishtinës.</p>	
<p>2. Kapitulli 16 i acquis-së: Tatimet</p>				<p>Neni 105 Tatimet - MSA</p>
<p>2.1.Zvogëlimi i nivelit të ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal;</p>	<p>Drejtoria e Inspektoriatit</p>	<p>1. Sa është numri i inspektimeve me qëllim të parandalimit të ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal?</p> <p>2. Cilat janë masat që ka ndërmarrë komuna juaj ndaj subjekteve ekonomike me qëllim të parandalimit të ekonomisë joformale?</p>		

2.2. Avancimi dhe zbatimimi i kornizës ligjore për ofrimin e shërbimeve publike, procedurave administrative dhe kontrollimin e kualitetit të tyre (Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal)

1.A ka komuna juaj Strategji për zhvillim ekonomik lokal, nëse po për çfarë periudhe?

2.A janë në përputhshmëri me SHZHEL, planet vjetore të punës së drejtorive?

3.Në çfarë periudha kohore raportojnë drejtorit mbi zbatueshmërinë ose sfidat e SHZHEL ?

4. A monitorohet zbatimi i Strategjis për Zhvillim Ekonomike Lokale, nëse po në kuader të cilës zyre / njësi monitorohet zbatueshmëria e SHZHEL ?

2.3. Zbatimi i Reformës së Menaxhimit të Financave Publike

1. Cilat janë vështësitë e komunës në planifikimin, realizimin dhe shpenzimin e qendrueshëm të financave lokale ?

2. Cilat janë veprimet që komuna i ka ndërmarrë për

			<p>përmisimin e menaxhimit të financave lokale (sipas rekomandimit të auditorit) ?</p> <p>3. A ka plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve të Auditorëve komuna juaj ?</p>		
	2.4. Planfikimi i pronës komunale për zhvillim ekonomik lokal		<p>1.A ka regjistër të pronës komunale komuna juaj?</p> <p>2.A është bërë lista e pronave të destinuara për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatëgjatë si dhe a është publikuar na ueb faqen zyrtare ?</p> <p>3. Sa biznese kanë përfituar pronë komunale për realizimin e projekteve investive ?</p> <p>3.A ka përfunduar të pronës komunale të cilët nuk kanë realizuar projekte sipas kontratës, nëse po qfarë veprime ka ndërmarë komuna juaj ?</p> <p>4.Sa është siperfaqja e</p>	<p>1. Komuna e Prishtinës e ka përfunduar, në bashkëpunim me “Helvetas” projektin e identifikimit dhe publikimit të të gjithë pronës së saj të paluajtshme. Informatat lidhur me këtë pikë gjenden në https://kk.rks-gov.net/prishtine/prone/lista-e-pronave-komunale/;</p> <p>2. dhe 3. Komuna e Prishtinës është në pritje të hyrjes në fuqi të legjislacionit të ri për dhënien e pronës komunale (tashmë ligji i ri është proceduar nga Qeveria, në përgatitjen e të cilin ligj Komuna e Prishtinës ka qenë e përfshirë intenzivisht) nga ky ligj do na mundësojë e lehtësojë, përkundër ligjit të kaluar, dhënien në shfrytëzim të pronave komunale edhe për nevoja të shfrytëzimit ekonomik të tyre. Në këtë drejtim, Drejtoria e Pronës e ka përgatitur një listë internet të të gjitha pronave komunale që mëton t’i ofrojë për shfrytëzim nga subjekte të ndryshme ekonomike, përmes qirave vjetore, sipas vlerës së tregut. Pra, për shkak të ndryshimeve legjislative, të cilat kemi ndihmuar që të ndodhim edhe i kemi</p>	

			pronës së paluajtshme në pronësi të komunës ?	pezulluar të gjitha veprimet, të cilat do i ndërmarrim menjëherë si të hyjë në fuqi ky ligj. Po ashtu, të gjitha pronat që janë duke u shfrytëzuar për nevoja ekonomike sipas kontratave të mëhershme, e të cilave i ka skaduar afati, do trajtohen sipas legjislacionit të ri; 4. – Sipërfaqja e pronës së paluajtshme komunale është 29964927.82 m ² ;	
	3. Kapitulli 20 i acquis-së: Ndërmarrjet dhe politikat e industrisë				
	3.1.Ndërtimi i një infrastrukture fizike, të kompletuar dhe të gatshme për ushtrimin e veprimtarive të bizneseve në		1. A është bërë funksionalizimi i zonave ekonomike në komunën tuaj ?		
	4.Tregu i brendshëm				
	4.1.Doganat dhe tatimet-Punësimi dhe politikat sociale, politikat e shëndetit publik	Drejtoria e Administratës	1.A janë ngritur kapacitetet për të zbatuar mbledhjen e tatimeve në komunat: Mitrovicë Veriore, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok?	1. 2 komuna (e Leposaviqit dhe e Zveçanit) nuk e kanë ngritur kapacitetin për të zbatuar mbledhjen e tatimeve në veri të Kosovës, komuna e Mitrovicës Veriore nuk ka ofruar informatë.	
3. BLOKU III: STANDARDET EVROPIANE					
	1.Kapitulli 11 i acquis-së: Bujqësia dhe zhvillimi rural				Neni 26 Bujqësia dhe Peshkatari a- MSA

<p>1.1.Zhvillimi i mëtejshëm i politikave në fushën e bujqësisë, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe acquis-së së transpozuar</p>	<p>Drejtoria për Bujqësi</p>	<p>1. A ka hartuar komuna juaj Plan Program për Bujqësi dhe Zhvillim Rural?</p>	<p>1. Drejtoria e Bujqësisë është duke hartuar strategjinë zhvillimore për bujqësi dhe zhvillim rural për periudhën pesëvjeçare- 2019-2023;</p>	
<p>1.2.Rregullimi i mëtejshëm i tokës bujqësore dhe mbrojtjes nga ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore</p>	<p>Drejtoria për Bujqësi</p>	<p>1.Sa është numri i kërkesave të parashtruara, pëlqimeve dhe vendimeve të lëshuara për ndërrimin e destinimit të tokës?</p> <p>2.A përfshin Plani zhvillimore komunale Zonat Urbane dhe Rurale, në komunën tuaj?</p> <p>3. A ka përgatitur komuna juaj Master planin për rregullimin e Tokës Bujqësore?</p>	<p>1. Brenda periudhës raportuese janë bërë gjithsej 6 kërkesa për dhënien e pëlqimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, prej tyre janë miratuar gjithsej 4 kërkesa (janë dhënë 4 pëlqime).</p> <p>2. Me planin zhvillimor komunal, pëveç zonave urabane, janë të përfshira edhe zonat rurale;</p> <p>3. Komuna e Prishtinës nuk ka ndonjë master-plan për rregullimin e tokës bujqësore;</p>	
<p>1.3.Konsolidimi i mëtejshëm i qendrave informative këshilluese komunale për</p>	<p>Drejtoria për Bujqësi</p>	<p>1.A janë funksionalizuar qendrat informative për trajnimin e fermereve në</p>	<p>1. Më 21.04.2017, është zyrtarizuar zyra – Qendra për Shërbime Këshillimore Bujqësore, Rurale të Kosovës, në Komunën e Prishtinës;</p>	

	bujqësi dhe zhvillim rural		komunën tuaj?		
	2.Kapitulli 12 i acquis-së: Politikat e sigurisë së ushqimit, fitosanitare dhe ato të veterinës				
	2.1.Përmirësimi i mbrojtjes së shëndetit publik dhe shëndetit të kafshëve	Drejtoria për Bujqësi	1.Sa është numri i fermerëve të trajnuar për mirëqenien e kafshëve?	1. Gajtë periudhës raportuese është mbajtur trajnimi “Sëmundjet e gjirit tek gjedhi” me më 08.06.2018 dhe 18.06.2018 trajnimi me të njëjtën temë; Janë trajnuar gjithsej 67 fermerë për mirëqenien e kafshëve dhe përmirësimin e kushteve higjienike në shtalla.	
	3. Kapitulli 15 i Acquis-së: Energjia				Neni 114 Energjia-MSA
	3.1. Reformimi i strukturave institucionale në fushën e energjisë dhe sigurisë bërthamore dhe ngritja e kapaciteteve të tyre, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe acquis-së së transpozuar	Drejtoria e Shërbimeve Publike	1. A ka miratuar komuna juaj Planin për Efiqencë të Energjisë? 2. Sa është numri i trajnimeve të mbajtura për zyrtarët komunal për	1. Plani për efiqence është hartuar, mirëpo nuk është miratuar. 2. Trajnimi dhe hartimi i planit komunal për efiqencë ka zgjatur 1 vit dhe është afruar asistencë teknike nga GIZ, po ashtu edhe është financuar. Pastaj plani i veprimit SEAP, po ashtu edhe trajnimet për efiqencë të energjisë në Industri dhe programeve për futjen e të dhënave për efiqencë për hartime të planeve komunale për energji, e cila është në realizim.	

			zbatimin e masave të dala nga Planet Komunale për Efiçencë të Energjisë?		
3.2. Ka pasur përparim në planifikimin e efiçencës së energjisë në komuna, por nevojat e kapaciteteve lokale duhet forcuar	Drejtoria e Shërbimeve Publike	<p>1.Cilat janë aktivitetet konkrete për zbatimin e planit për efiçencë të energjisë, specifikoni së paku tri projekte?</p> <p>2.Sipas planit të energjisë efiecence a ka nxjerr komuna statistika sa i përket uljes se kosotove, në aktivitet e parapara në plan, si psh. ndriqim publikë dhe ne sistemet e ngrohjes ne objektet publikë nga vitet paraprake ?</p>	<p>1. a) Ndërrimi i kaldave në shkolla dhe objekte tjera komunale; b) Sistemi i koogjenerimit nga Termokosi dhe c) Zgjerimi i ndriçimit dhe modernizimi i rrjetit ekzistues i ndriçimit publik, me kursim mbi 60%;</p> <p>2. Në sistemin e ndriçimit publik kosto e kursimit ne modernizimin të ndriçimit është mbi 50%, ne modernzim dhe kthimi i investimit është 3.5 vite, po ashtu edhe në koogjenerim nga Termokosi ka kursim të energjisë mbi 80 MhW;</p>		
4. Kapitulli 23 i acquis-së: Gjyqësori dhe të drejtat themelore					

<p>4.1.Promovimi i mundësive të barabarta dhe lufta kundër diskrimimit</p>	<p>Njësia për të Drejtat e Njeriut</p>	<p>1.Cilat janë veprimet që ka ndërrmar komuna juaj, për zbatimin e Ligjit për mbrojtje nga Diskriminimi?</p> <p>2.A është caktuar zyrtari për mbrojtjen nga diskriminimi në komunën tuaj?</p>	<p>1. Kemi mbajtur një trajnim informues për mbrojtje nga diskriminimi;</p> <p>2. Koordinatori për DNJ është ngarkuar edhe me këtë punë, por jo formalisht ;</p>	
<p>4.2.Incimi i funksionalizmit të Komunitetit Konsultativ për Personat em Aftësi të Kufizuar</p>		<p>1.A është themeluar Komiteti konsultative për Personat me Aftësit të Kufizuar në komunën tuaj ?</p> <p>2. A zbatohet Ligji për mbrojtje nga Diskriminimi në respektimin e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar?</p>	<p>1. Po, dhe funksionon sipas mandatit në mënyrë të rregullte;</p> <p>2. Po, sipas mundësive, mirëpo ende ka vend për përmirësime;</p>	
<p>4.2.Ofrimi i ndihmës juridike falas për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, pa dallim etnie</p>	<p>Drejtoria e Administratës</p>	<p>1. A është funksionalizuar Zyra për ndihmë juridike falas?</p> <p>2. Sa është numri i personave të cilët kanë kërkuar ndihmë juridike falas (numri i personavëve, gjinia dhe etnia).</p>	<p>1. Në Komunën e Prishtinës nuk eshte funksionalizuar Zyra për ndihmë juridike falas, por zakonisht ekziston një praktikë, ku qytetarët marrin këshilla nga Zyra ligjore, ku është i angazhuar staf i mjaftueshëm;</p>	

			3. A është bërë rekrutimi i zyrtarëve për ndihmë juridike falas në komunën tuaj ? SA është numri i zyrtarëve në zyrën juridike për ndihmë falas		
	4.3. Ngritja e kapaciteteve institucionale në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale	Drejtoria e Administratës	<p>1. A është caktuar zyrtari komunal për mbrojtjen e të dhënave personale? (komuna e mbetur Zubin Potokut)</p> <p>2. A është trajnuar zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale në komunën tuaj?</p> <p>3. A është funksionalizuar baza e të dhënave personale për zyrtarët komunal?</p>		Neni 84 Mbrojta e të dhënave personale - MSA

<p>4.4. Duhet siguruar që Zyrat Komunale të Gjendjes Civile (ZKGJC) dhe zyrat e vendit të plotësojnë kriteret e sigurisë për regjistrimin civil, por edhe kriteret e ruajtjes dhe mbajtjes së dokumenteve personale</p>	<p>Drejtoria e Administratës</p>	<p>1.A është ngritur siguria fizike e dokumentacionit (roja fizike, vendosja e kamerave, grilat, kasafortat,etj.)?</p> <p>2. A mbahen librat fizik në komunën tuaj? Nëse jo, kur do fillohet të bëhet kjo?</p>	<p>1. Po, siguria fizike e dokumentacionit është sipas rregullave dhe konsultave me ARC-në (Agjencioni për Regjistrimin Civil);</p> <p>2. Po, librat fizikë janë në Komunë;</p>	
<p>4.5. Verifikimi i kërkesave të personave të riatdhesuar, respektivisht tek gjendja civile në komuna, si dhe përmes Zyrës për Komunitete dhe Kthim (ZKK) dhe Komisionit Komunal për Ri-integrim</p>	<p>Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim</p>	<p>1. A është funksionale Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim ?</p> <p>2. Sa zyrtarë janë në Zyren Komunale për Komunitete dhe Kthim ?</p> <p>3. Cila është përbërja e ZKKK-ve sipas përkatësisë etnike.</p> <p>4.Në komunën tuaj, a bëhet verifikimi i kërkesave të personave të riatdhesuar përmes Zyrës Komunale të Gjendjes Civile, Zyrës për Komunitete dhe Kthim, si dhe Komisionit Komunal për Ri-integrim?</p>	<p>1. Zyra komunale per komunitete dhe kthim është funksionale;</p> <p>2. Shefi i ZKKK-së dhe dy zyrtarë për kthim dhe mundësi të barabarta;</p> <p>3. Dy zyrtarë të komunitetit shqiptar dhe një e komunitetit serb;</p> <p>4. Në zyrën komunale per komunitete dhe kthim bëhet verifikimi i kërkesave nga zyrtarët, pastaj vendimin e merr komisioni komunal për riintegrim;</p>	

4.6. Ofrimi i mundësive për kthim për personat e zhvendosur

**Zyrës
Komunale për
Komunitete
dhe Kthim/
Drejtoria e
Shëndetësisë
dhe
Mirëqenës
Sociale**

1. Sa është numri i personave të zhvendosur të rikthyer, të cilët janë regjistruar në komunën tuaj?

2. Sa është numri i shtëpive të rindërtuara për të rikthyerit?

3. Sa është numri i aplikimeve për asistencë nga fondi për ri-integrim?

4. Sa është numri i aplikimeve për zhvillimin e bizneseve nga personat e riatdhesuar?

5. Sa është numri i personave të riatdhesuar të cilët janë pajisur me dokumente personale?

1. Për periudhën raportuese nuk ka persona të zhvendosur;
2. Po ashtu, për periudhën raportuese nuk kemi shtëpi të rindërtuara;
3. E kemi një rast (1) të aplikimit për asistencë;
4. Nuk ka pasur aplikime për zhvillimin e bizneseve;
5. Janë 39 të lajmëruar në ZKKK, udhëzuar në QAP dhe ZKP për pajisje me dokumente personale (informata në Zyrën e gjendjes civile lidhur me dokumentet personale);

Drejtoria e Shëndetësisë:

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale: - Komuna e Prishtines ka vullnet politik per ofrimin e mjedisit të sigurtë dhe mundësinë e kthimit të të gjithë qytetareve të vetë, të cilët janë zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës, pa dallim etnie, feje dhe përkatësie politike;

<p>4.7. Zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Komunitetet RAE dhe përmirësimi i shkallës së regjistrimit civil për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas</p>	<p>Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim</p>	<p>1.Sa është numri i personave të regjistruar nga komunitet Rom, Ashkali dhe Egjiptian?</p> <p>2. Sa është numri i fushatave të realizuara të regjistrimit falas?</p> <p>3. A është miratuar Plani Lokal i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në komunën tuaj?</p>	<p>1. Gjithsej rreth 520 persona, 80 familje të komunitetit ashkali, 5 familje të komunitetit rom dhe 1 familje të komunitetit egjiptian, të deklaruar;</p> <p>2. Gjate kësaj periudhe është realizuar një fushatë e regjistrimit civil falas;</p> <p>3. Ende jo, është mbajtur takimi konstituiv, më 17 dhe 18 korrik, do të mbahen takimet e ardhshme;</p>	
<p>5. Kapitulli 24 i acquis-së: Drejtësia, liria dhe siguria</p>				<p>Neni 83 Liria, Siguria dhe Drejtësia-MSA</p>
<p>5.1.Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës së politikave në fushën e migracionit, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe të legjislacionit të përafuar</p>	<p>Zyra Komunal për Kthim dhe Komunitete</p>	<p>1. A është miratuar Plani Lokal i Veprimit për Riintegrim në komunën tuaj? (Prishtinë, Mitrovicë Veriore, Zveçan, Leposavic dhe Zubin Potok)</p>	<p>1. Po, është miratuar më 27.05.2016;</p>	

5.2. Të përmirësohet siguria dokumenteve, duke siguruar zbatimin e dispozitave të MSA-së dhe legjislacionit vendor

**Drejtoria e
Administratës**

1. A është përfunduar procesi i digjitalizimit të librave të gjendjes civile të kthyer nga Serbia?

2. Sa zyrtar komunal janë certifikuar (që u janë nënshtruar testit të njohurive ligjore/procedurale dhe të sistemit)?

1. Procesi i digjitalizimit të librave të gjendjes civile nuk i përket nivelit lokal;
2. Gjatë periudhës **janar - qershor 2018**, janë 38 zyrtarë të certifikuar që punojnë në zyrat e gjendjes civile në Komunën e Prishtinës;

6. Menaxhimi i Kufirit dhe Migracionit

**Neni 85-
Vizat, menaxhimi i
kufijve,
azili dhe
migracioni-
MSA**

6.1.Puna dhe roli i Këshillat Lokale për Siguri Publike, (KLSP) dhe Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi, (EVS) të cilat përveç që duhet të jenë funksionale ato duhet të jenë edhe produktive

Zyra e Kryetarit

1.A është funksional Këshilli Komunal për siguri në bashkësi (KKSB) në komunën tuaj?

2. Sa është numri i takimeve të mbajtura nga KKSB ?

3. A është funksional Këshilli Lokal për Siguri Publike (KLSP) në komunën tuaj ?

4. Sa është numri i takimeve të mbajtura nga (KLSP) ?

5. A është funksional Ekipi Vepruese për Siguri (EVS) në komunën tuaj ?

6. Sa është numri i takimeve të mbajtura nga EVS ?

1. Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 03.05.2018, mori Vendim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, (i bashkangjitur vendimi);

2. Janë mbajtur 2 takime (i bashkangjitur plani i punës dhe plani i veprimit për 2018);

3. Po, janë 6 KLSP në komunën e Prishtinës;

4. Takimet mbahen në baza mujore;

5. Po, është funksional;

6. Po, është mbajtur një takim;

6.2. Të dëshmojnë rezultate konkrete në fushën e luftimit të narkotikëve

Drejtoria për Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale/Drejtoria e Arsimit/Policia e Kosovës

1. Çfarë aktivitete janë ndërmarrë nga komuna, në luftën kundër drogave dhe parandalimit të trafikimit të narkotikëve?

1. Drejtoria e Shëndetësisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, kanë organizuar ligjërata me tema të ndryshme në disa shkolla të komunës së Prishtinës, ku një ndër to ka qenë edhe për luftën kundër drogave dhe parandalimit të trafikimit të narkotikëve.

* Komuna e Prishtinës në përputhje me Strategjinë kombëtare të Republikës së Kosovës kundër narkotikëve dhe planit të veprimit, ka hartuar ***“Strategjinë lokale kundër narkotikëve dhe Planin e veprimit të Komunës së Prishtinës ndërkufitare. 2017-2019”, me qëllim që kjo strategji lokale parasheh dhe shtyenë organizatat përkatëse që t’i zbatojnë përgjegjësitë e tyre në planin e veprimit, siç parasheh kjo strategji. Janë zhvilluar aktivitete me qëllim të:***

a. Ngritjes së nivelit të njohurive tek të rinjtë mbi drogat dhe përdorimin e tyre;

b. Ngritjes së nivelit të njohurive të profesionistëve dhe prindërve, për punën me të rinjtë në drejtim të parandalimit nga përdorimi i drogave dhe krijimi i varësisë;

c. Fuqizimit të programeve për parandalimin dhe përdorimin e drogave ndërmjet të rinjve, nëpërmjet aktiviteteve specifike;

				<p><i>d. Përmirësimin të bashkëpunimit dhe koordinimit mes organizatave qeveritare dhe joqeveritare për realizimin e aktiviteteve programore për parandalim.</i></p> <p>Drejtoria e Arsimit:</p> <p>1. Drejtoria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, kanë organizuar ligjërata me tema të ndryshme në disa shkolla të komunës së Prishtinës, ku një ndër to ka qenë edhe për luftën kundër drogave dhe parandalimit të trafikimit të narkotikëve;</p>	
	7. Kapitulli 26 i acquis-së: Arsimi dhe kultura				Neni 107 Arsimi dhe trajnimi - MSA
	7.1. Ngritja e kapaciteteve teknike për Arsimin Gjithpërfshirës	Drejtoria e Administratës	1. A është pajisur me pajisje të teknologjisë informative 1 qendër burimore në Komunën e Prishtinës?	1. Qendra burimore e pajisur me pajisje të teknologjisë informatike dhe funksionale;	
	7.2. Zbatimi i planit të veprimit nga Strategjia ndërmministrorë për shkollat promovuese të shëndetit 2009-2018	Drejtoria për Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale/Drejtoria e Arsimit	1. A janë ndërmarrë aktivitetet vetëdijësuese në shkolla për shëndet dhe mjedis? Nëse po, Sa ka qenë numri i pjesëmarrësve, cila	1. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit – Komuna e Prishtinës, ka bërë implemetimin e projektit për edukimin dhe promovimin shëndetësor, në shkollat e	

ka qenë mosha, gjinia, etnia

Prishtinës. Ky projekt është i rëndësishëm për edukimin e rinisë, duke marrë parasysh se në të ka tema të ndryshme e mjaft interesante dhe relevante për moshën e nxënësve si:(higjiena, stili i jetës së shëndoshë(ushqimi dhe aktiviteti fizik), delikuenca (duhani, alkooli, droga), Edukimi seksual (shëndeti riprodhues, sëmundjet seksualisht transmissive), komunikimi (barazia gjinore, dhuna, ngacmimi, etiketimi), shëndeti oral, shëndeti mendor (depresioni). Në këtë projekt do të përfshihen të gjitha shkollat, mirëpo fillimisht në këtë projekt janë përfshirë disa SHFMU, siç janë: “Qamil Batalli”, “Nazim Gafurri”, “ Naim Frasher”, “Ismail Qemail” etj.

Drejtoria e Arsimit:

1. Drejtorinë e Arsimit e Komunës së Prishtinës, ka bërë implemetimin e Projektit për edukimin dhe promovimin shëndetësor në shkollat e Prishtinës. Ky projekt është i rëndësishëm për edukimin e rinisë, duke marrë parasysh se në të ka tema të ndryshme e mjaft interesante dhe relevante për moshën e nxënësve, si: (higjiena, stili i jetës së shëndoshë (ushqimi dhe aktiviteti fizik), delikuenca (duhani, alkooli, droga), edukimi seksual (shëndeti riprodhues, sëmundjet seksualisht transmissive), komunikimi (barazia gjinore, dhuna, ngacmimi, etiketimi), shëndeti oral, shëndeti mendor (depresioni). Në këtë projekt do të përfshihen të gjitha shkollat, mirëpo fillimisht në këtë projekt janë përfshirë tri

				shkolla: SHFMU “Pjetër Bogdani”, “Xhavit Ahmeti” dhe “Shkëndija”.	
	7.3. Rritja e nivelit të pjesëmarrjes së fëmijëve në institucionet e edukimit parashkollor dhe fëmijët me nevoja të veçanta	Drejtoria e Arsimit	<p>1.Sa është numri i nxënësve dhe studentëve përfitues të bursave nga komuna juaj</p> <p>2.A është zbatuar udhëzuesi për mësimdhënës për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta në mësim-nxënie?</p> <p>3. Sa është numri i fëmijëve të cilët janë përfshirë në institucionet e arsimit parashkollor?</p> <p>4.A është hartuar pakoja e materialeve për informimin e prindërve rreth rëndësisë së arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe a është bërë shpjegimi i procedurave të regjistrimit?</p>	<p>1. Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës në vitin 2018, ka ndarë njëqind e njëzet (120) bursa për studentët e komunës së Prishtinës.</p> <p>2. DKA, komfor udhëzimeve administrative, krijon kushtet të barabarta për përfshirjen e të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim dhe edukim. Ekipi vlerësues komunal për fëmijët me nevoja të veçanta, ka vlerësuar fëmijët në bazë të kërkesave të shkollave, prindërve, ku secili fëmijë i vlerësuar ka raportin e tij të vlerësimit ka raportin e tij dhe rekomandimet nga ekipi profesionalë vlerësues.</p> <p>3. Gjatë periudhës janar - qershor 2018, gjithsej numri i fëmijëve me nevoja te veçanta në institucionet parashkollore është 51 fëmijë me nevoja të veçanta.</p> <p>4. Prindërit janë të informuar për procedurat e regjistrimit dhe rëndësisë së arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta. MASHT, konkretisht Divizioni për fëmijë me nevoja të veçanta, ka bërë hartimin e udhëzimeve administrative, si dhe broshurave të ndryshme të cilat ne i implementojmë.</p>	

	<p>7.4. Raportim me të dhëna mbi numrin e braktisjes së shkollimit nga komuniteti pakicë, në veçanti komuniteti RAE. Veprimet konkrete të ndërmarra nga komuna në parandalimin e mëtejshëm të braktisjes së shkollimit</p>	<p>Drejtoria e Arsimit</p>	<p>1.Sa është numri i braktisjes së shkollimit nga komuniteti pakicë?</p> <p>2.Cilat janë aktivitetet të cilat kanë marrë komunitet në parandalimin e braktisjes së shkollimit?</p>	<p>1. Në Komunën e Prishtinës janë gjithsej 10 fëmijë që kanë braktisur shkollimin, mirëpo asnjëri prej tyre nuk i përket komunitetit pakicë.</p> <p>2. Për të gjithë ata që kanë braktisur shkollimin, DKA organizon mësim intenziv në SHFMU “Emin Duraku”.</p>	
	<p>7.5. Harmonizimi i ofertës dhe kërkesës së tregut të punës përmes hartimit të standardeve të profesionit dhe rishikimit të kurrikulave</p>		<p>1. Sa shkolla profesionale janë në komunën tuaj (specifikoni drejtimet/profilet)?</p> <p>2.Sa është numri i nxënësve në shkollat profesionale në komunat tuaja?</p> <p>3.Cilat janë format e përfshirjes së nxënësve në punët profesionale(praktike)?</p> <p>4.Në kuadër të të cilëve</p>	<p>1.Në Komunën e Prishtinës gjithsej numrojnë shtatë (7) shkolla profesionale me profile të ndryshme.</p> <p>2.Numri i nxënësve në shkollat profesionale të komunës së Prishtinës është rreth 4990 nxënës në të gjitha profilet.</p> <p>3.Nxënësit punët praktike profesionale i realizojnë në mënyra të ndryshme, në bazë të profileve përkatëse si :</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Puntori bujqësore, ✓ Firma kontabiliteti, ✓ Firma ndërtimore, 	

			<p>sektor të biznesit janë më tepër të angazhuar nxënsit në punë profesionale ?</p> <p>5.Cilat janë format e promovimit të shkollave profesionale ?</p>	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Shtypshkronja, ✓ Postë-Telekom, ✓ Dyqane hoteliere dhe restauronte, ✓ Kabinete të ndryshme , ✓ Korporatën Energjetike të Kosovës, ✓ Shtëpi të shëndetit dhe ordianca private, ✓ Dyqane farmaceutike etj. <p>5.Qendra për Karrierë ofron promovime të profileve të ndryshme për të gjitha shkollat e mesme dhe profesionale të komunës së Prishtinës. MASHT, në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës, organizojnë panairë të ndryshme rreth promovimit të shkollave profesionale, si psh. “Dyert e hapura”.</p>	
	<p>7.6. Përmirësimi i sigurisë rrugore. Ulja e aksidenteve për 20%, krahasuar me vitin paraprakë</p>	<p>Drejtoria e Arsimit/ Zyra e Kryterit</p>	<p>1.Çfarë veprime ka ndërmarr komuna sa i përket vetëdijesimit në shkolla nw edukimin për siguri rrugore?</p> <p>2.A ka ndare komuna juaj subvencione për OJQ apo ka bashkëpunuar me ndonjë projekt sa i përket kësaj fushe?</p>	<p>1. Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës në bashkëpunim me MASHT dhe “Tempulli”, kanë ndërmarr aktivitete të ndryshme për vetëdijesimin dhe edukimin për siguri rrugore në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Në të gjitha institucionet kanë organizuar ligjërata të ndryshme me karakter vetdijësues; ✓ Aktivitete me biçikleta, së bashku me Policinë e Kosovës; 	
	<p>8. Kapitulli 27 i acquis-së: Mjedisi</p>				<p>Neni 115 Mjedisi-MSA</p>

<p>8.1. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë</p>	<p>Drejtoria e Shërbimeve Publike</p>	<p>1.A është hartuar plani për menaxhimin e mbeturinave komunale?</p> <p>2. Cfare aktivite ka ndërmarrë komuna e juaj për zbatimin planit për menaxhimin e mbeturinave komunale?</p> <p>3. A është hartuar plani i veprimit për cilësinë e ajrit në komunën tuaj ?</p>	<p>1. Komuna e Prishtines e ka të hartuar Planin për menaxhimin e mbeturinave. Poashtu, e ka të hartuar dhe miratuar Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave;</p> <p>2. Sipas Rregullores së menaxhimit të mbeturinave, ashtu edhe me Planin për menaxhim të mbeturinave, është paraparë dhe janë bërë hapa konkretë në drejtimin e menaxhimit të plotë të mbeturinave. Këto hapa janë bërë duke marr përsipër edhe faturimin e mbeturinave dhe lidhjes së kontratës me KRM “Pastrimi”;</p> <p>3. Plan i veprimit për cilësinë e ajrit është hartuar dhe janë marrë masa në përmirësimin e cilësisë së ajrit;</p>	
<p>8.2. Ngritja e kapaciteteve administrative në nivelin lokal, për zbatimin e ligjit për mbeturina</p>	<p>Drejtoria e Shërbimeve Publike</p>	<p>1.Sa është numri i punëtorive të organizuara në komunën tuaj për hartimin e planeve komunale dhe rregulloreve për mbeturina?</p> <p>2. Sa është numri i stafit të trajnuar ?</p>	<p>1. Numri i punëtorive të organizuar për hartimin e planit dhe rregullores komunale është 6;</p> <p>2. Numri i stafit të trajnuar është 3 persona;</p>	
<p>8.3. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë</p>	<p>Drejtoria e Shërbimeve Publike</p>	<p>1.Sa është numri i fushatave të ndërmarra për ndërgjegjësimin publik për sistemin e menaxhimit të mbeturinave?</p>	<p>1. Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur dy (2) fushata vetëdijesuese;</p>	
<p>8.4. Përmirësimi i qasjes, cilësisë, qëndrueshmërisë financiare të performancës mjedisore</p>	<p>Drejtoria e Shërbimeve Publike</p>	<p>1. A është përgatitur vlerësimi dhe plani reformues i sektorit të menaxhimit të mbeturinave</p>	<p>1. Po</p>	

<p>të sektorit të menaxhimit të mbeturinave</p>		<p>të ngurta?</p> <p>2. A është përfunduar studimi i parafizibilitetit për deponinë e mbeturinave komunale në Gjilan dhe Dragash</p> <p>3. A është përgatitur inventari për mbeturina të rrezikshme dhe vlerësimi i gjendjes?</p>	<p>2. Menaxhimin e deponive për mbeturina e bën niveli qendror, në veçanti Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Sipas informatave që kemi, kjo është duke u kryer në bashkëpunim me GIZ-in;</p> <p>3. Trajtimi i mbeturinave të rrezikshme është në kompetencën e MMPH;</p>	
<p>8.4.Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë</p>	<p>Drejtoria e Shërbimeve Publike</p>	<p>1. A ka bërë Pastrimin e Lumit Lepenc nga mbeturinat. (Komuna e Hanit të Elezit dh Kaçanikut)</p>	<p>1. Po, është bërë pastrimi i lumit Llap (pjesa e cila koalon në territorin e komunës së Prishtinës) dhe i lumit Prishtevka;</p>	
<p>8.5.Zbatimin i masave për mbrojtjen e Zonave Ujore Sanitare</p>	<p>Drejtoria e Shërbimeve Publike</p>	<p>1. A ka përfshirë komuna e juaj zonat e mbrojtura ujore sanitare në Planin Rregullues detajore?</p>	<p>1. Po, Komuna jonë i ka të përfshira të gjitha zonat e mbrojtura ujore në planet e saj;</p>	

<p>8.6. Numri i madh i deponive ilegale duhet të adresohet urgjentisht</p>	<p>Drejtoria e Shërbimeve Publike</p>	<p>1. Sa është numri i deponive ilegale në komunën tuaj dhe çfarë masa ka ndërmarrë komuna për të eliminuar këto deponi?</p>	<p>1. Komuna e Prishtinës çdo vit largon të gjitha deponitë ilegale që krijohen. Numri i të cilave sillet rreth 90 copë;</p>	
<p>8.7. Direktiva nr. 2002/49/KE lidhur me vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës në mjedis</p>	<p>Drejtoria e Inspektoriatit /</p>	<p>1. Sa kërkesa kanë qenur nga qytetarët për prishje të rendit dhe qetësisë për pengesa të zhurmës së krijuar në mjedis ?</p> <p>2.Çfarë masa janë ndërmarr nga Inspektorati Komunal ?</p> <p>3.Sa dënime janë bërë mbi prishjen e rendit dhe qetësisë së zhurmës në mjedis ?</p> <p>4.A janë të njoftuara lokalet afariste deri në çfarë mase është e lejuar sipas ligjit në fuqi ngritja e zërit dhe në cilat orare lejohet ?</p> <p>5.Cilat janë sfidat e drejtorisë suaj dhe bizneseve lokale për mos zbatimin e këtij ligji ?</p>	<p>1. Kompetencë e Policisë të Kosovës</p> <p>2. Njoftim i Policisë dhe inspektimit të përbashkët.</p> <p>3. Drejtoheni Policisë së Kosovës për informata.</p> <p>4. Po, janë të njoftuar.</p> <p>5. Sfidë mbetet mungesa e pajisjeve për përcaktim të zhurmës dhe rregullorja komunale.</p>	
<p>9. Bujqësia dhe peshkataria</p>				

<p>9.1. Masat e ndërmarra për mbrojtjen e tokës bujqësore</p>	<p>Drejtoria e Inspektoratit</p>	<p>1.A ka komuna juaj inspektor te bujqesise?</p> <p>2. Sa është numri i kërkesave të parashtruara?</p> <p>3. Sa është numri i lejeve të lëshuara?</p> <p>4. Sa është numri i inspektimeve?</p> <p>5. Sa është numri i fletëparaqitjeve të parashtruara?</p>	<p>1. Inspektorët e bujqësisë përfshihen në inspektorët e rendit komunal;</p> <p>2. Gjatë periudhës raportuese, janar – qershor 2018, janë parashtruar 297 kërkesa dhe ankesa;</p> <p>3. Janë gjithsej 195 pëlqime sanitare;</p> <p>4. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar 1153 inspektime ng Rendit komunal;</p> <p>5. 297 lëndë (gjoba dhe lëndë në Gjykatë)</p>	
<p>9.2. Planet për menaxhimin e tokave rurale (zonimi)</p>	<p>Drejtoria e Bujqësisë</p>	<p>1.A posedon komuna e juaj Planin për Menaxhimin e tokave rurale?</p>	<p>1. Jo, Komuna nuk e ka planin per menaxhimin e tokës rurale;</p>	
<p>10.Zhvillimi Rajonal</p>				<p>Neni 119 Zhvillimi rajonal- MSA</p>
<p>10.1.Pjesëmarrja e komunës në programet e BNK-së (bashkëpunimit ndërkufitar)</p>	<p>Zyra Kryetarit të komunës</p>	<p>1.Sa është numri i projekteve të BNK-së që komuna është pjesëmarrëse?</p>	<p>1. Numri i bashkëpunimeve ndërkomunale me komuat që kufizohet territorialisht komuna e Prishtinës, janë (3).</p> <p>2. Bashkëpunimi me Komunën e Obiliqit në fushën e infrastrukturës në shtrimin e rrugës me</p>	

				<p>bashkëfinancim në fshatrat Barilevë – Breznicë.</p> <p>3. Me Komunën e Fshë-Kosovës dhe Obiliqit, në fushën e transportit publik.</p> <p>1. Me Komunën e Gracanices në fushën e urbanizmit. Marreveshje nga viti 2010.</p>	
10.2.Marrëveshjet e bashkëpunimit ndër-komunal dhe bashkëpunimit komunal ndërkombëtar	Zyra e Kryetarit të komunës	<p>1.Sa është numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit komunal?</p> <p>2.Sa është numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit komunal ndërkombëtar?</p>	<p>1. Numri i bashkëpunimeve komunale ndërkombëtare për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018, është si vijon:</p> <p>Komuna e Prishtinës është dakorduar dhe ka marë aprovimin e Kuvendit komunal për Binjakëzim me Komunën e Des Moines, Iowa, SHBA.</p> <p>Fusha e bashkëpunimit – bujqësia dhe zhvillimi profesional në këtë fushë.</p> <p>2. Qyteti i Mannheim - Republika e Gjermanisë.</p> <p>Jemi dakorduar me Komunën Mannheim - Gjermani për vizitë zyrtare të Kryetarit të Komunës së qytetit Mannheim dhe delegacionit gjerman në Prishtinë.</p> <p>Fushat e bashkëpunimit me Drejtorinë e Kadastrit dhe të Shëndetësisë.</p> <p>3. Anëtarësim në rrjetin e komunave /qyteteve të Evropës “Major Cities of Europe” .</p> <p>Pjesëmarrje në rrjet dhe konferencë. Prezentimi i të arriturave në Komunën në Prishtinë në fushën e digjitalizimit të administratës dhe transparencës.</p>		
11.Kapitulli 28 i acquis-së: Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit publik					Neni 81 Mbrojtja e konsumatorit- MSA

11.1.Mbrojtja e Shëndetit të Nënës, Fëmijës dhe Shëndetit Riprodhues

**Drejtorja e
Administratës
/Drejtorja e
shëndetësis**

1. Sa trajnime ka organizuar komuna juaj për shëndetin e nënës dhe e fëmijës?

DSHMS ka organizuar dy trajnime për shëndetin e nënës dhe fëmijës, me temat:

1. Menagjimi seksual riprodhues në gjendje emergjente;
2. Vlerësimi i rritjes dhe zhvillimit të fëmijës;